

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.(L.) B. nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 161 par.4 lidhur me par. 2 të KPK-së, dhe në vazhdimësi për veprën penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 dhe 1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzave të PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.5044/2012 e dt.09.10.2012, PP.nr.536/2012 e dt. 19.10.2012, PP.nr.6539/2012 e dt. 06.11.2012, PP.nr.6540/12 e dt. 23.11.2012, PP.nr.2794/2012 e dt. 09.07.2012, PP.nr.5045/2012 e dt. 07.09.2012, PP.nr.7723/2013 e dt. 16.07.2015, PP/II.nr.5701/13 e dt. 02.09.2013, PP/II.nr.7251/2013 e dt. 12.11.2013, PP.nr.7250/13 e dt.22.07.2015, PP.II.nr.5705/2013 e dt. 05.09.2013, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 22.04.2016, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Rexhep Maqedonci, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av N. R., me datë 25.04.2016 në prezencën e të akuzuarit, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 24.05.2016, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

E. B., biri i L. dhe nënës I., e vajzërisë D., i lindur më datë *data e lindjes...*, në fshatin D., KK P., ku edhe tani jeton, me nr. Personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion Agjurator, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, më parë i gjykuar për veprë të njëjtë, ndaj zhvillohet edhe procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse,

I.Me datën 09.05.2012, rreth orës 18:20,në vendin e quajtur “A. e D.” rreth Liqenit të B., në pyllin e mbrojtur me destinim të posaçëm me të cilin menaxhon Korporata Energjetike e Kosovës, i pandehuri që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë dru zjarri dhe atë 90 trungje të llojit bungu me dimensione 10 m të gjata, diametër 11-14cm,me vëllim të përgjithshëm 4m³, me ç`rast të dëmtuarës Korporatës Energjetike të Kosovës, sh.a në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 18.07.2012, rreth orës 07:20, në vendin e quajtur "A.e D." rreth liqenit të B., në pyllin pronë e Korporatës Energjetike të Kosovës, sh. a në Prishtinë, i cili pyll është mbrojtur dhe ka destinim të posaçëm, i pandehuri është hasur duke prerë 35 trungje të llojit bingu, me gjatësi 12m, me diametër 12-14cm, me vëllim të përgjithshëm 3.50m³, me ç`rast të dëmtuarës Korporatës Energjetike të Kosovës, sh. a në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 21.05.2012, rreth orës 18:16, me qëllim të vjedhjes në pyllin me destinim të veçantë me të cilin qeverisë Korporata Energjetike e Kosovës, në vendin e quajtur "B.i D." përreth Liqenit të B., ka prerë 45 trungje të llojit shkozë, të gjata 10m, me diametër 14-16cm, me vëllim prej 2.20m³, me ç`rast të dëmtuarës KEK-ut, zyra në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë kishte për të kryer në vazhdimësi veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle për këto vepra penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës

Ndërsa i akuzuari me shënime si më lartë,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse,

II. Me date 20.04.2012, rreth orës 11:00, në fshatin B., Komuna P., i dëmtuari-pylltari N. J., është kanosur seriozisht se do të privohet nga jeta, nga i pandehuri i lartcekur, për shkak se të njëjtën ditë, i dëmtuari duke e kryer detyrën si pylltarë, në vendin e quajtur "Z.", kishte hasur në të pandehurin i cili ishte duke prerë dru në pyllin pronë shoqërore, dhe gjatë përpjekjes për ta ndaluar për të mos e dëmtuar pyllin, është fyer dhe kanosur nga i pandehuri i cili ju ka drejtuar me fjalët, ti je ai që mi ke marrë drutë para një jave të xhamia e B., largohu nga këtu se ka me të pre me motor sharrë, duke shkaktuar kështu shqetësim të madh, ndjenjën e ankthit, frikës dhe pasigurisë të dëmtuarit të lartcekur.

Me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 161 par. 4 lidhur me par. 2 të KPK-së,

III. Me dt.12.08.2012, rreth orës 05:45 në vendin e quajtur "M. i K."-B. i Sh., përreth Liqenit të B., me të cilin qeverisë Korporata Energjetike e Kosovës, i cili është me destinim të veçantë, me qëllim të përfitimit e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka prerë dru zjarri të llojit shkozë, me diametër 18-25cm, në gjatësi 22m, me vëllim të përgjithshëm 4m³, me ç`rast të dëmtuarës Korporatës Energjetike të Kosovës, i shkakton dëm material.

Me dt.17.08.2012, rreth orës 08:10, në vendin e quajtur "M. i K.", përreth L. të fshatit B., në pyllin në mbrojtje të posaçme të cilin e menaxhon Korporata Energjetike e Kosovës, me qëllim të vjedhjes ka prerë trungje të drunjtëve të llojit shkozë, me diametër 14-16cm, gjatësi 10-11m, me vëllim të përgjithshëm prej 6m³, me ç`rast të dëmtuarës KEK-ut në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 27.08.2012, rreth orës 14:43, në vendin e quajtur “Rr. e Q.”, përreth Liqenit të B., në pyllin e mbrojtur me destinim të posaçëm me të cilin menaxhon Korporata Energjetike e Kosovës, i pandehuri që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë dru zjarri dhe atë trungje të llojit shkoze me dimensione 12 m të gjata, diametër 12-14cm, me vëllim të përgjithshëm $4m^3$, me ç`rast të dëmtuarës Korporatës Energjetike të Kosovës sh. a në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.10.06.2013, rreth orës 19:25, në vendin e quajtur “M. i K.” përreth liqenit të B., në pyllin e mbrojtur me destinim të posaçëm me të cilin menaxhon Korporata Energjetike e Kosovës, i pandehuri në bashkëveprim, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë dru dhe atë 83 copë trungje të llojit shkozë, me dimensione 10m të gjata, diametër 12-14cm, me vëllim të përgjithshëm $2.24m^3$, me ç`rast të dëmtuarës, Korporatës Energjetike të Kosovës, sh. a në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 21.06.2013, rreth orës 17: 43, i pandehuri E. B., me qëllim vjedhje, në pyllin e mbrojtur me destinim të posaçëm, pronë e Korporatës Energjetike të Kosovës, në vendin e quajtur “Z.” përreth Liqenit të B., KK P., është zënë në flagrancë nga roja e pyllit, duke prerë dhe marrë 118 trungje të llojit bingu, të gjata 10m, me diametër 10-12cm, me vëllim të përgjithshëm $2.78m^3$, me ç`rast të dëmtuarës Korporatës Energjetike të Kosovës- Prishtinë, sh.a i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 22.08.2013, rreth orës 08:15, në pyllin publik të quajtur “L. i D.” përreth Liqenit të B., në pyllin pronësi e Korporatës Energjetike të Kosovës, sh.a.i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme, vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë 68 copë trungje të llojit shkozë me dimensione 10m, me diametër 14-16 cm, me vëllim të përgjithshëm $2.24m^3$, me ç`rast të dëmtuarës Korporatës Energjetike të Kosovës, sh. a i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 22.08.2013, rreth orës 18:15, në pyllin publik të quajtur “L. i D.” përreth Liqenit të B., në pyllin e mbrojtur me destinim të posaçëm me të cilin menaxhon Korporata Energjetike e Kosovës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme, vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë dru zjarri dhe atë 183 copë trungje të llojit bingu me dimensione 12m, me diametër 12-14 cm, me vëllim të përgjithshëm $3.60m^3$, me ç`rast të dëmtuarës KEK, në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,23,41,42,43,45,46,73,74, nenit 358 të KPRK-së dhe nenit 161 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365,450,453,463,370 të KPPRK-së, për të dy veprat veç e veç dënimet i`a,

PËRCAKTON

Për veprën penale si në dispozitivin në pikën **II**, të këtij aktgjykimi, e gjykon me dënim me burg, në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Për veprën penale si në dispozitivin në pikën **III**, të këtij aktgjykimi, e gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 1 (një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

Me aplikimin e nenit 80 të KPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarin E. (L.) B., me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej **4 (katër) muaj**, të cilin do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 1 (një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në afat prej një (1) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzetë euro), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **100€ (njëqind/euro)**, në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. E dëmtuara Korporatës Energjetike të Kosovës, Sh. A, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzat, PP.nr.5044/2012 e dt. 09.10.2012, PP.nr.536/2012 e dt.19.10.2012, PP.nr.6539/2012 e dt. 06.11.2012, PP.nr.6540/12 e dt. 23.11.2012, PP.nr.2794/2012 e dt. 09.07.2012, PP.nr.5045/2012 e dt. 07.09.2012, PP.nr.7723/2013 e dt. 16.07.2015, PP/II.nr.5701/13 e dt. 02.09.2013, PP/II.nr.7251/2013 e dt. 12.11.2013, PP.nr.7250/13 e dt. 22.07.2015, PP.II.nr.5705/2013 e dt. 05.09.2013, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 161 par.4 lidhur me par. 2 të KPK-së, dhe për veprat penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 dhe 1 e KPK-së, si dhe veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata paraprakisht ka verifikuar të kaluarën kriminale për të akuzuarin e lartcekur dhe duke pasur parasysh parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetit të procedurës penale, me pajtimin e palëve respektivisht të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, bazuar në nenin 35 par.8 të KPRK-së, mori aktvendim që të bashkohet procedura penale dhe të zbatohet procedurë unike kundër të

akuzuarit E. B. për lëndët: P.ka.nr.390/12, P.ka.nr.418/12, P.ka.nr.461/12, P.ka.nr.472/12, P.nr.728/12, P.nr.1775/12, P.nr.37/13, P.nr.784/13, P.nr.1030/13, P.nr.88/14 dhe P.nr.613/15, dhe tani e tutje procedura penale për këto lëndë do të mbaj numrin më të vjetër **Pka.nr.390/12**.

I akuzuari deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u deklarua i pa fajshëm për veprat penale për të cilat akuzohet.

Prokurori shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Mbetem në tërësi pranë aktakuzave të cilat janë të argumentuara me prova dhe të mbështetura me ligj dhe kërkoi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. B. av. N. R. i autorizuar vetëm në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.04.2016, në këtë çështje penale, fjalën përfundimtare i'a dorëzoi gjykatës me shkrim në të cilën ka theksuar se aktakuzat e prokurorisë nuk përmbajnë dyshimin se i akuzuari E. B. ka kryer veprat penale sipas aktakuzave ngase këto aktakuza janë ngritur duke u bazuar në fletëparaqitje të punëtorëve të sigurimit dhe nuk kanë njohuri të sakta dhe nuk mund ti argumentojnë me asnjë dëshmi të vetme, ngase rojet e sigurimit për ti vërtetuar pretendimet e tyre asnjëherë nuk i kanë ndaluar dhe sekuestruar drunjtë e prerë siç e pohojnë se kinse e kanë parë E. duke prerë drunjtë, si dhe nuk kanë mundur për asnjërin rast ta mbështesin me fotografi apo dokumentacion të veçantë madje ata pohojnë se ditarët e punës i kanë pasur gjithëherë në zyre ku dhe e kanë shkruar E. ku dyshohet se ata kanë mundur vetëm ta shohin duke kaluar rrugës dhe e kanë shkruar. Ndërsa Propozim akuzës PP.nr. 2794/2012 të datës 09.07.2012 me të cilën E. B. akuzohet për rastin Kanosje nga neni 161. par 4 lidhur me par. 2 të KPK-së, nuk është siguruar asnjë provë e vetme që dëshmon se është kryer vepra penale, nga se dëshmitari A. H. në deklarimin e tij thotë se E. dhe N. janë fjalosur paksa, janë sharë mese vete dhe i ka pajtuar të akuzuarin dhe të dëmtuarin, mbi këtë bazë nuk janë plotësuar elementet e veprës penale nga se nuk ka pasur asgjë serioze. Gjykatës i propozoj që të akuzuarin E. B. ta liroj nga përgjegjësia për veprat penale të cilat i vihen në barrë dhe ta shpallë të pa fajshëm në mungesë të provave sipas nenit 364 të KPPRK-së, të nxjerr aktgjykim lirues pasi që nuk është provuar me asnjë provë të vetme se ai ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi, nuk është e vërtetë se i kam kryer këto vepra penale, sa i përket kanosjes ndaj pylltarit N. J., nuk është e vërtetë se e kam kryer këtë vepër penale, nga se ka qenë plan i B. B. dhe N. J. që të më akuzojnë si dhe nuk është e vërtetë se i kam kryer veprat penale vjedhje pylli, këta kanë punuar në mënyrë paushalle dhe më kanë shkruar fletëparaqitje, ngase nuk është e vërtetë se më kanë takuar në pyll në vitin 2012 e këndeje sepse unë punoj në rrugë të fshatit O. si Agjustator. Në fshatin e B. B. dhe N. J. janë së paku 20 shtëpi, si dhe disa fshatra tjera të cilët e shfrytëzojnë atë rajon ku jam akuzuar vetëm unë. Si dhe në fjalën përfundimtare theksoi se pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij dhe kërkoi nga gjykata ta shpallë të pafajshëm dhe ta liroj nga këto aktakuza.

Gjykata gjatë procedurës se provave ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin N. J., Dëshmitarët: I. S., A. H. dhe F. S., të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një

dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Gjykata ka marrë aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nën par 1.3 të KPRK-së, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet, sipas dispozitivit nën I, të këtij aktgjykimi të pjesa e aktgjykimit lirues, nga se dëshmitari tani i ndjerë S. (S.) B. ka vdekur me datë 07.05.2015, gjë që vërtetohet në bazë të Certifikatës të vdekjes lëshuar nga Komuna e Podujevës zyra e Gjendjes civile me nr. Serik me nr. të ref...../.....RV/..... të datës 15.01.2016, Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit, dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme, dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe në favor të tij, dhe bazuar në nenin 361 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar, në mungesë të provave tjera vendosi me aktgjykim lirues.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike për veprat penale për të cilat i akuzuari u shpall fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari-dëshmitari N. J. lidhur me veprën penale kanosje në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Në vitin 2012 në fshatin Z. mbi liqenin e B. i pandehuri E. B. kishte qenë duke prerë dru dhe unë i thash ndërpreje sepse unë jam roja e pyllit, i njëjti nuk e ka ndërprerë dhe më tha se ti nuk guxon mem ardhur mua te motori dhe me motor sharrë të ndezur u nis në drejtim timin i cili më kërcënoi se kam me ta hjek kryet, jam larguar 5 metra nga ai, e ka lëshuar motor sharrën dhe e ka marr një dru në dorë, i njëjti vazhdimisht më ka sharë, e në ato çaste ka ardhur A. H. dhe e ka qetësuar situatën e unë i ftova policinë.

Dëshmitari A. H. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: me datë 20.04.2012 rastësisht kam takuar E. B. dhe N. J. të cilët shaheshin në mes veti për shkak se roja e pyllit N. J. ja kishte pas marr drutë disa herë E., i cili thoshte kam me të pre me motor sharrë të cilin e kishte të ndezur, unë ju afrova dhe ia hoqa motorin. Me datë 17.08.2012 rreth orës 08:10 min në vendin e quajtur "M. i K." te liqeni i B. e kam takuar E. i cili ka qenë me Sharrë motorike dhe traktor universal të cilit i kam shkruajtur flet paraqitje e që atë ditë u largua mirëpo prapë e kam takuar disa herë. Me datë 27.08.2012 rreth orës 14:43 min në vendin e quajtur "Rr. e Q." rreth liqenit të B. e kam parë E. duke prerë dru, i kam thënë ndalu se nuk bënë me pre dru, por i njëjti prapë ka prerë dru. Me datë 22.03.2013 rreth orës 18:15 në vendin e quajtur "L. i D." rreth liqenit të B. kemi shkuar në bazë të zhurmës së motorit dhe e kemi takuar E. B. duke prerë dru i njëjti u tërheqte por prapë vazhdojke ditëve të tjera. Me datë 21.06.2013 rreth 17:43 min në vendin e quajtur "Z." në liqenin e B. kam hasur E. B. aty është vendi te muri i B. ku i kemi pasur zyret kemi dëgjuar zhurmën e motorit dhe kemi shkuar në vendin e ngjarjes ku e kemi parë E. B. i kemi tërhequr vërejtjen për tu larguar, u tërheqte, mirëpo prapë vazhdojke, ne vetëm i shkruajshim fletëparaqitje, po ashtu me datë 10.06.2013 në orën 19:25 min ne malin e quajtur "M. i k." e kemi takuar E. e që edhe ky vend është afër murit të liqenit të B.s duke prerë dru me motorë sharrë dhe i njëjti ishte me traktor universal dhe ram.

Dëshmitari I. S. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: me datën 12.08.2012 rreth orës 5:45 në vendin e quajtur "M. i K. – B. i Sh.", përreth liqenit të B., kemi qenë me pylltarin e ndjerë S. B., e kemi hasur të pandehurin E. B. duke prerë dru në mënyrë të kundërligjshme e që

ishite së bashku me vllaun e tij të cilët ishin me traktor universal me ram pa tabela dhe me sharrë motorike. Po ashtu me datë 22.08.2013 rreth orës 8:15 min në vendin e quajtur livadhi i D. rreth liqenit të B. më kujtohet që ka qenë i pandehuri duke prerë dru dhe duke i ngarkuar në ram i cili ishte me një vëlla të vogël dhe duke i bartur me traktorin e tij universal, i kemi tërhequr vërejtjen që ta ndal punën e kemi ftuar policinë dhe shefin e kompanisë por nuk kanë ardhur.

Dëshmitari F. S. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Me datë 17.08.2012 në orën 8:10 min, e kam takuar në vendin e quajtur "M. i K." në pyll E. B. i cili kishte qen duke prerë dru dhe e kishte ngarkuar ramin deri në gjysmë, ja kemi tërhequr vërejtjen që të largohet nga pylli dhe drutë nuk ja kemi konfiskuar, gjatë orarit të punës kemi mbajtur ditar të punës-një fletore të thjesht dhe mbas përfundimit të orarit të punës nga fletorja i kemi evidentuar në ditar bazë, ne i kemi ftuar disa herë policinë por asnjëherë nuk kanë ardhur.

Nga fletëparaqitjet për ngritjen e procedurës penale të cilat gjenden në shkresat e lëndës të përshkruara data koha dhe vendi i kryerjes së veprave penale, vërtetohet gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plotë deklaratave të dëmtuarit N. J., dëshmitarit A. H., I. S. si dhe F. S., ashtu që vepra penale kanosje është vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarit-pylltarit N. J. dhe dëshmitarit A. H., se i akuzuari me motor sharrë të ndezur u nis në drejtim të dëmtuarit duke e "kanosur se kam me ta hjek kokën", e të cilat dëshmi ndërlidhen njëra me tjetrën, ndërsa vepra penale vjedhje pylli në vazhdimësi është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve: A.H., I. S. dhe F. S., të cilët e kanë identifikuar në mënyrë bindëse në shqyrtimin gjyqësor të akuzuarin të cilin e kishin takuar disa herë duke prerë dru në mënyrë të kundërligjshme në pronën e KEK-ut, e të cilat dëshmi ndërlidhen njëra me tjetrën se vërtet i akuzuari ka kryer veprat penale si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata po ashtu në mënyrë të hollësishme e ka analizuar fjalën përfundimtare të mbrojtësit të akuzuarit av.N. R., qëndron fakti se në shkresat e lëndës nuk ka foto dokumentacion apo vendim mbi sekuestrim apo konfiskim të sendeve (drunjëve apo sendeve të cilat kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale), mirëpo dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor e kanë identifikuar të akuzuarin se e kanë takuar disa herë duke prerë dru në mënyrë të kundërligjshme me data, kohë dhe vende si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kontestues është vetëm fakti sa i përket vlerës së dëmit të shkaktuar, po ashtu vepra penale Kanosje është vërtetuar nga i dëmtuari N. J. dhe dëshmitari A. H., se i akuzuari e ka kanosur të dëmtuarin me mjet rrezikshëm se do ti shkaktoj lëndim të rëndë trupor "*motor sharrë të ndezur u nis në drejtim të dëmtuarit duke kanosur se kam me ta hjek kryet*", e të cilat dëshmi ndërlidhen njëra me tjetrën.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, ka zbatuar ligjin më të favorshëm në kuptim të nenit 3 par.2 të KPRK-së, ashtu që beri rikualifikimin e veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 dhe 1 të KPK-së, në vepër të njëjtë penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, si dhe ka konstatuar se i akuzuari në vazhdimësi ka

kryer veprat penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, pasi që e dëmtuara është e njëjtë, objekti i veprës penale i njëjtë si dhe dashja e kryerësit të veprës penale, të parapara me nenin 81 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 të KPRK-së.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Kanosje nga neni 161 par.4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe në vazhdimësi të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari i ka kryer veprat penale me dashje, me paramendim, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe e ka dashur kryerjen e veprës penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit lidhur me të akuzuarin E. B., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti se ishte korrekt gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se i njëjti është recidivist, ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepra penale të njëjta, sipas aktgjykimeve dënuese me numra: P.nr.507/2010, P.nr.623/2010, P.nr.1071/2011, P.nr.1119/2011, P.nr.1643/2012, P.nr.1054/2013 dhe P.nr.339/2014 të gjitha të formës së prerë, si dhe zhvillohet procedurë penale edhe për vepra tjera të njëjta, si dhe duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, duke mos i respektuar zyrtarët në ushtrimin e detyrave brenda fushë veprimtarisë së tyre ligjore, si dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur që është pylli i mbrojtur me destinim të posaçëm, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilin dënim do ta mbaj pasi aktgjykim të merr formën e prerë.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, në mënyrë që të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, për shkak se për gjykatën ishte kontestuese pasi që i akuzuari e ka kontestuar fletëparaqitjet mbi vlerësimin e dëmit dhe nuk ka pasur ekspertizë nga ndonjë institucion i pavarur, në mënyrë që gjykata të vërtetojë saktësisht dëmin e shkaktuar, ashtu që dëmi i vlerësuar vetëm nga punëtorët e sigurimit-dëshmitarët nuk parqet bazë të sigurt për gjykim, andaj gjykata nuk e pranoi dhe mbi këtë bazë e dëmtuara është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
Pka.nr.390/2012 të dt. 24.05.2016

Sekretare juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.